

Shkolla e Mesme “Franklin Learning Center”

-A Pennsylvania Blue Ribbon School of Excellence-

-Middle States Association Accredited School-

616 N. 15th Street

Philadelphia, PA 19130

Znj Nicole Lee, Drejtore
Dr. LaTrina Stewart, Ndihmës Drejtor
Z. Anthony , Ndihmës Drejtor

215-400-7570,
215-400-7571 (faks)

Korrik, 2021

Letër për Rishikimin e Programit Mësimor

Të nderuar Prindër / Familjarë të Shkollës “Franklin Learning Center”:

Shpresojmë që kjo letër t’ju gjejë mirë dhe po shijoni muajt e verës.

Drejtoria Arsimore e Filadelfias është në fazat e planifikimit për një kthim të sigurt në mësimin në-person për të gjithë studentët. Pandemia COVID-19 ka prekur drejtorinë tonë dhe mundësitë për fëmijët tanë, në shumë mënyra, por ne jemi të përkushtuar të bëjmë gjithçka që mundemi për të rimarrë dhe përmirësuar rezultatet e studentëve këtë vit. Një ndryshim që po bëjmë, si pjesë e një strategjie më të gjerë për përmirësimin e rezultateve për të gjithë studentët, është fazimi në një qasje të standardizuar për kohën ditore të fillimit dhe mbarimit .

Këtë vit, me mbështetjen e Shërbimeve të Transportit, të gjitha oraret e autobusëve do të përputhen me një nga tre kohët e programeve. Standartizimi i kohës së programit do të ndihmojë në zvogëlimin e kohës që studentët kalojnë në autobuzë, ndihmon në sigurimin e autobusëve në kohë më shpesh, lejon pastrimin në nivel më të lartë të autobusëve midis ndërrimit të turneve dhe do të ndihmojë Zyrën e Shërbimeve të Transportit të kapërcejë një ulje të konsiderueshme në personel për shkak të largimeve dhe daljes në pension gjatë 18 muajve të fundit.

Për shkak të prindërve që shprehin shqetësime për kohën e hershme të fillimit, Drejtoria Arsimore e Filadelfias ka lejuar që Shkolla Franklin Learning Center të ketë të njëjtin orar që kemi pasur për shumë vite. Dita jonë e shkollës përsëri do të fillojë në 7:55 të mëngjesit dhe do të përfundojë në 2:59 pasdite. Unë kërkoj falje për çdo konfuzion që letra e mëparshme mund të ketë shkaktuar. Ne po e sigurojmë këtë informacion tani në mënyrë që ju të filloni të bëni çdo rregullim të nevojshëm familjar para kohe për të siguruar që fëmija juaj të mund të ndjekë shkollën në kohë çdo ditë në përputhje me këtë orar të ri.

Më shumë informacion në lidhje me kthimin tonë në shkollë në vjeshtë, dhe mundësitë për ju që të merrni pjesë në takime dhe ngjarje të nivelit të shkollës dhe rajonit, do të ndahen me ju gjatë “ Back to School Night” të Drejtorisë deri në 31 Gusht - dita e parë e shkollës. Ndërkohë, unë ju inkurajoj të vizitoni rregullisht faqen e internetit të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias për informacione më të azhuruara: www.philasd.org.

Ju urojme një verë të sigurt dhe të shëndetshme.

Sinqerisht,

Nicole Lee
Drejtorë

Translation and Interpretation Center (07/2021) 21-22 FLC Bell Schedule English Revised (Albanian)